Kronikë

Fier/ Shisnin kanabis në doza, arrestohet 37 vjeçari, në kërkim i ati (EMRI)

Një 37 vjeçar nga Peshtan Bregas, Fier është arrestuar në flagrancë pasi policia i gjeti lëndë narkotike kanabis të ndarë në doza

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
16 Nëntor, 12:26 | **Përditësimi: 16 Nëntor, 12:59**

Share

Fier- Një 37 vjeçar nga Peshtan Bregas, Fier është arrestuar në flagrancë pasi policia i gjeti lëndë narkotike kanabis të ndarë në doza. Ndërkohë në kërkim është shpallur babai i tij 61 vjeç.

Në bazë të kontrolleve të kryera blutë gjetën në makinën e Joni (Ervin) Muçaj sasi të lëndës së dyshuar narkotike kanabis sativa.

Ndërsa në shtëpi përveç kanabis të ndarë në doza gati për shitje policia njofton se gjetën dhe sekuestruan 12 fishekë arme gjahu, 3 gërshërë që shërbenin për të përgatitur (ndarë) lëndën narkotike, një shumë parash prej 2 milionë lekë dhe 700 euro dhe 5 celularë.

LEXO EDHE:
33 vjeçari i dha fund jetës në Gjermani, mbërrin në Fier trupi i pajetë i Dritan Lalaj

Operacioni u kodua Peshtani.

> *"Specialistët për Hetimin e Narkotikëve të DVP Fier, në kuadër të kontrolleve për parandalimin e shitjes së lëndëve narkotike, në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme Shqiponja, pas një pune të mirëfiltë policore kanë finalizuar operacionin policor të koduar "Peshtani".*
>
> *Për këtë rast u arrestua shtetasi J(E). M., 37 vjeç, banues në fshatin Peshtan Bregas, Fier. Gjatë kontrollit fizik dhe të automjetit që ky shtetas drejtonte, shërbimet e Policisë kanë gjetur doza të lëndës së dyshuar narkotike cannabis sativa.*
>
> *Nga kontrolli i banesës shërbimet e Policisë kanë gjetur një sasi lëndë të dyshuar narkotike cannabis sativa, e ndarë në qindra doza gati për shitje, 12 fishekë arme gjahu, 3 gërshërë që shërbenin për të përgatitur (ndarë) lëndën narkotike, një shumë parash prej 2 milionë lekë dhe 700 euro, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale bashkë me 5 celularë.*
>
> *Për këtë rast u shpall në kërkim shtetasi D. M., 61 vjeç, banues në fshatin Peshtan Bregas, babai i shtetasit J(E). M", informoi sot policia.*

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Fier | kanabis | Joni Muçaj | Ervin Muçaj

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

16 Nëntor, 09:13

Kush ka pension më të ulët bonus më të madh në fundvit? Si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

'Ngordhën bretkosat jo më peshqit', ndotet nga fabrikat Emisari i Tërbufit në Divjakë! Banorët: Me këtë ujë vadisim tokat

Yrjet Saliasi

15 Nëntor, 14:53

Aksidenti tragjik në aksin Tepelenë-Fier, ku humbën jetën bashkëshortët! Arrestohet shoferi i autobotit, dyshohet se ishte përgjumësh kur ndodhi përplasja

15 Nëntor, 11:45

Tepelenë, do shisnin 30 kg kanabis dhe një kallashnikov, 4 të arrestuar! Në pranga babë e bir që transportonin thasët me kanabis në makinë (EMRAT)

15 Nëntor, 09:14

Ndotet sërish lumi Gjanica në Fier, kompanitë e naftës derdhin mbetjet hidrokarbure në ujë (VIDEO)

Marsela Topi

14 Nëntor, 17:24

VIDEO/ Aksident tragjik në rrugën Tepelenë-Fier, vdesin bashkëshortët! Makina u përplas me autobotin e ujit, plagoset dhe çifti tjetër (EMRAT+DETAJET)

Marsela Topi

14 Nëntor, 07:26

Siqeca e Patosit, fshati turistik me ujëvara në mal, por pa ujë në fshat! Banori: Këtu ka vite që nuk vijnë nuset

Marsela Topi

13 Nëntor, 14:58

Fier/ Arrestohet 18 vjeçari, u kap në flagrancë me dhjetëra doza kanabisi të cilat i shiste në qytet! I sekuestrohen edhe dy celularë

13 Nëntor, 12:55

Shisnin drogë në qytetin e Vlorës dhe të Fierit, 11 të arrestuar, 2 të tjerë në kërkim, një i mitur nën hetim! Si funksiononte organizata (EMRAT+VIDEO)

12 Nëntor, 13:39

Lezhë/ Lëviznin me kanabis në makinë, arrestohet 19 vjeçari, 3 në hetim (EMRI)

11 Nëntor, 16:09

SPAK mbyll hetimet për grupin e Laert Haxhiut, dërgohen për gjykim 9 të akuzuarit! Nga vrasje, vënie eksplozivi te vjedhje, zbulohen akuzat! Ngjarjet u zbardhën nga rrëfimi i Tafanit

11 Nëntor, 15:03

Fier/ Mjeti në ecje përfshihet nga flakët, shpëton mrekullisht shoferi! Shkak një shkëndijë elektrike (VIDEO)

10 Nëntor, 17:46

Laura, njihuni me italianen që la Bolzanon për Roskovecin! Flet për Report Tv: Shqipëria, vend i sigurt dhe miqësor

Kristaq Thano

10 Nëntor, 15:13

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje